



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 16/2015

Prishtinë, më 21.04.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Visar Ymeri, zëvendëskryetar i parë i Komisionit, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Munguan: Muhamet Mustafa, kryetar dhe Sasha Milosavleviq - anëtar.

Pjesëmarrës i ftuar: Dritan Gjonbalaj - drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnike Ukmata dhe Burim Dinarama- AAC; Lumnije Murati- ZRPK; Lejla Selimi-OSBE; Dardan Abazi – INDEP; Qëndresa Mrasori-KDI; Fehmi Pireva- Kuvendi i Kosovës; Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Visar Ymeri, zëvendëskryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 7 dhe 8.4.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 7 dhe 8.4. 2015

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 7 dhe 8.4.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014

Visar Ymeri, kryesuesi – Në fillim, i njoftoi deputetët se në mungesë të kryetarit të Komisionit, do ta udhëheqë mbledhjen si zëvendëskryetar i parë i Komisionit, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, për shkak se kryetari Muhamet Mustafa ndodhet jashtë vendit. Më tutje, tha se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet raporti vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit të Aviacionit Civil - AAC-së, z. Dritan Gjonbalaj, i cili do të bëjë një prezantim të shkurtër për këtë raport në Komision, pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC– Fillimisht i njoftoi anëtarët e Komisionit për misionin dhe vizionin e AAC-së. Me këtë rast, Gjonbalaj theksoi se AAC-ja ka krijuar një ambient të aviacionit, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit. Ai tha se AAC-ja i raporton Kuvendit, në lidhje me zbatimin e ligjit dhe politikave të aviacionit civil. AAC-ja është funksionale nga 1 janari i vitit 2009 dhe është themeluar sipas Ligjit për aviacionin civil, si agjenci e pavarur, rregullator përgjegjës për rregullimin e sigurisë së aviacionit dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Ai i ceku katër institucione publike që kanë përgjegjësi në aviacion: Ministrinë e Infrastrukturës, AAC-në, MPB-në dhe KHAIA. Theksoi se funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta, në përputhje me standardet në fuqi. Gjatë prezantimit të raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014, z.Gjonbalaj i paraqiti të gjitha aktivitetet, në mënyrë kronologjike si vijon: rreth 30 inspektime të avionëve të huaj në platformë; 74 raporte të ndodhive, duke përfshirë 35 raporte të goditjes së shpendëve në avion dhe 33 raporte të ndriçimit të mjeteve ajrore me dritë laser; 23 leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit; licencimi i 9 pilotëve të aviacionit të përgjithshëm - deltaplan dhe paraglajd; OSHNA ANP “Adem Jashari” dy auditime gjithëpërfshirëse dhe një numër inspektimesh. Gjithashtu, theksoi vlerësimin e kompetencës profesionale të stafit, mbikëqyrjen e rilokimit në objektin e ri dhe rilokimit të pajisjeve, ripërtëritjen e licencave për 30 kontrollorët, inspektimet e shumta në ANP “Adem Jashari”, aprovimi i heliportit të parë në Perlepnice të Gjilanit, shënjimi dhe ndriçimi i të gjitha antenave, në përputhje me Rregulloren e AAC-se dhe vlerësimi i të gjitha fushave ajrore në Republikën e Kosovës. Për aktivitet legjislativ, tha se ligji i jep kompetencë drejtorit të përgjithshëm të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e Ligjit për aviacionin civil dhe standardeve relevante ndërkombëtare dhe evropiane. Kemi nxjerrë 9 rregullore për të reflektuar zhvillimet e fundit legjislativ në rrafshin ndërkombëtar. Gjithashtu, janë nxjerrë edhe 5 manuale dhe materiale udhëzuese që burojnë nga këto rregullore. Me këto manuale, lehtësohet implementimi i rregulloreve nga inspektorët tanë dhe nga entitetet e inspektuara. Për ISO 9001:2008, tha se është shtëpia certifikuese e sistemit për menaxhimin e cilësisë “Bureau Veritas”, pas certifikimit të AAC-së në vitin 2013, sipas ISO 9001:2008, me afat trevjeçar, ajo edhe auditon AAC-në çdo vit për të verifikuar kushtet për mirëmbajtje të kësaj certifikate, kompania, në muajin mars, ka kryer auditimin në AAC, me qëllim të verifikimit të zbatimit të plotë të kërkesave të ISO-s 9001:2008, brenda AAC-së dhe funksionimit të sistemit për menaxhim të cilësisë. Ai tha se

raporti i auditimit nuk ka listuar ndonjë gjetje për AAC-në dhe ka konfirmuar se AAC-ja përmbush të gjitha kërkesat e standardit, në bazë të cilit është certifikuar. Për bashkëpunimin me institucionet tjera të shtetit përgjegjëse për aviacion, tha se AAC-ja ka përkrahur institucionet tjera të shtetit, për të garantuar një sistem rregullator funksional dhe të koordinuar mirë; ka përgatitur një koncept për dokumente për anëtarësim në ICAO, ECAC dhe EUROCONTROL për Ministrinë e Punëve të Jashtme; softuerin për telefona të mençur me të drejtat e udhëtarëve (MI); Policinë e Kosovës. Biletat e aeroplanit për fluturimet në ANP, tash nuk e kanë më kodin RS, por IATA që ka zëvendësuar këtë kod me kodin e përkohshëm XK. Gjithashtu, IATA ka shtuar në sistemin TIM kodin RKS për pasaportat e Republikës së Kosovës. Lidhur me aktivitetet në rrafshin ndërkombëtar, theksoi bashkëpunim shumë të mirë me Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë në fushën e inspektimeve dhe auditimeve të aviacionit civil, bashkëpunimin me Francën. Kemi nënshkruar një MOU me Hungarinë, më 13 dhe 14 maj 2014, programi ISIS - Implementimi i Legjislacionit të Qiellit të Vetëm Evropian në Evropën Juglindore, kemi mbajtur takimin e nivelit të lartë të Këshillit Drejtues të Programit ISIS. Në përputhje me vendimin e Këshillit të NATO-s, ofrimi i përkohshëm i shërbimeve në këtë hapësirë i është dhënë HungaroControl-it për një periudhë pesëvjeçare. Prosesi vazhdon me normalizimin e plotë të hapësirës së ulët ajrore të Kosovës (korridore të reja, aviacioni i përgjithshëm). Për raportin vlerësues të Komisionit Evropian dhe zbatimi i ECAA, tha se në bazë të një analize krahasuese të raporteve të progresit 2014, të vendeve të rajonit, palë të Marrëveshjes HPEA, Kosovën e rendit të parën në listë për nga progresi në përmbushjen e kërkesave legjislative të fazës së kësaj marrëveshjeje. Ai theksoi se këtë vit, AAC-ja do të jetë nikoqir i takimit të radhës së Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes ECAA. Sidoqoftë, vihen në pah disa çështje që pritet të adresohen prej nesh, siç është certifikimi i ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe fillimi i zbatimit të plotë të Ligjit mbi Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Për Statistikat e vitit 2014, tha se ka një rënie prej 14% në numrin e udhëtarëve në ANP, krahasuar me vitin 2013. Sipas hulumtimeve tona, kjo rënie i atribuohet motit të keq dhe anulimit të fluturimeve gjatë sezonit të dimrit, subvencioneve të Qeverisë së Maqedonisë në Aeroportin e Shkupit, mundësisë së qytetarëve tanë të udhëtojnë me vetura përmes Serbisë, si dhe falimentimit të kompanisë “Belle Air Europe”. Sidoqoftë, në muajt e parë të këtij viti, ka një rritje të trafikut prej rreth 10%, në krahasim me vitin e kaluar. Lidhur me ndihmën shtetërore të Maqedonisë për agjencitë ajrore të fluturimeve, ai theksoi se po praqet një pengesë në konkurrencën e lirë të ekonomisë dhe për këtë e kemi njoftuar Komisionin Evropian. Ai, në fund të ekspozesë, paraqiti planin pesëvjeçar strategjik të AAC-së për vitet 2014-2019, duke i prezantuar objektivat strategjike dhe duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e atyre strategjike.

Kryesuesi– Ngriti çështjen e rekomandimeve të Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aviacionin civil, të datës 5.5.2014, se a ka pasur veprim për zbatimin këtyre rekomandimeve nga AAC. Për emërimin e zëvendës drejtorit të ACC-së nga Qeveria që është në raport, a ka pasur bazë ligjore Qeveria për këtë emërim? A ka ekzistuar nevoja për pozitën e zëvendës drejtorit? Për buxhetin që ju është shkurtuar, a ndikon kjo në punën e AAC-së? Për nivelin e rënies së kënaqshmërisë së udhëtarëve në ANP, a ka rënie të shërbimeve apo cili është problemi? Si do ta adresoni rënien e kënaqshmërisë? Mundësia që kompania ajrore e Serbisë të aterrojë në ANP, a është kjo pjesë e marrëveshjes me Serbinë? A keni informata ju si AAC?

Raif Qela – Theksoi se është një raport gjithëpërfshirës, që për nga ana teknike është punuar mirë, që tregon një seriozitet të lartë, ka transparence për mënyrën e shpenzimit të buxhetit dhe që e pasqyron punën AAC-së. Raporti vjetor i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, i cili e rendit Kosovën të parën në rajon për nga progresi në përmbushjen e kërkesave legjislative në këtë fushë, është edhe një dëshmi e punës së mirë që ka bërë AAC-ja, me nxjerrjen e akteve nënligjore e rregulloreve të nevojshme. Pyeti: Pse AAC-ja ende nuk është anëtarësuar në Agjencinë Evropiane të Aviacionit Civil, ku janë shkaqet dhe sa po ndikon ky mosanëtarësim në

punën e AAC-së? Pas marreje së shërbimeve ajrore për fluturime të ulëta nga Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror, tani për shërbimet e hapësirës së lartë ajrore, çka duhet të veprohet që të merret përsipër edhe kjo pjesë e shërbimeve? Për subvencionet që po i ofron aeroporti i Maqedonisë, a keni të dhëna se çfarë subvencionesh po ju ofrojnë udhëtarëve?

Blerim Grainca -Tha se është një raport profesional dhe i detajuar mirë teknikisht. Ai parashtroi pyetje për çmimin e biletave nga Kosova që është shumë i lartë. Cilat janë arsyet e çmimeve të biletave që janë më të lartat në krahasim me shtetet e rajonit? Për anulimet e fluturimeve të shumta që po ndodhin në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” a ju janë kompensuar udhëtarëve dëmet e shkaktuara? Gjithashtu, tha se ka raste kur udhëtarët blejnë biletat, por nuk ka vend në aeroplan. A është reflektuar kjo në rënien e numrit të udhëtarëve? Për çështjen e sigurisë, cilat janë masat që kanë ndërmarrë institucionet e sigurisë, a ka informata AAC-ja për këtë çështje?

Duda Balje – Pyeti: Si po funksionon AAC-ja, kur dihet se që dy vite nuk ka Bord mbikqëqyres? Si është situata në këtë drejtim, cilat janë sfidat?

Pal Lekaj – Është një raport shumë përmbajtësor, që jep shumë të informata të detajura. Pyeti për rënien e numrit të udhëtarëve deri në 14%, cilat janë arsyet? Kompania “LIMAK” që ka me koncesion ANP “Adem Jashari”, a ka përmbushur të gjitha obligimet, që mos të bie numri i udhëtarëve? Biletat, sidomos ato sezonale, janë shumë të larta dhe për një familje është shumë, sepse kursimet vjetore i shkojnë në bileta. Për çështjen Aeroportit të Gjakovës, pyeti: Pse nuk po hapet ky aeroport alternativ? Dhe, për të ardhmen, a ka plan nga AAC-ja, çka do të bëhet me këtë aeroport? Thuhet që 20 vite nuk ka të drejtë të hapen aeroporte tjera dhe rreth 100 km përreth aeroportit të Prishtinës, nuk mund të ketë aeroporte alternative, çka mendoni për këtë? Lidhur me subvencionet që po bën Maqedonia për kompanitë ajrore, a mendoni se edhe në Kosovë duhet të ketë subvencione, nëse po a duhet t’i bëjë Qeveria apo kompania “LIMAK”?

Besim Beqaj – Raporti i punës së AAC-së është një raport me informata të sakta dhe me krahasime të detajura. Parashtroi disa pyetje: Cilat janë përfitimet në aspektin ekonomik nëse lejohet hapësira e lartë ajrore e kontrollimit të fluturimeve dhe kur jeni të gatshëm t’i merreni këto kompetenca? Cilat janë angazhimet që ka ndërmarrë ANP-ja, lidhur me anulimet e fluturimeve? Për subvencionet që po iu bën Maqedonia kompanive ajrore, përveç anës ligjore, a keni informatë nga AAC-ja e Maqedonisë, sa po i subvencionon turistët? Për çështjen e subvencionve, tha se këtë çështje duhet ta trajtoni së bashku me Komisionin e Konkurrencës.

Enver Hoti – Pyeti për tri auditimet e brendshme që i janë bërë AAC-së: Cilat janë rekomandimet që kanë dalë nga këto tri auditime? Lidhur me Bordin e AAC-së, a ka nevojë të ketë Bord AAC-ja? Sepse jeni duke funksionuar edhe pa të që dy vite. Për rënien e udhëtarëve në ANP, a janë fajtorë edhe agjencitë ajrore turistike? Lidhur me matjen e kënaqshmërisë, tha se është mirë t’i shohim ato pyetje dhe disa prej përgjigjeve.

Sala Berisha- Shala – Në këtë raport është një pasqyrë e mirë e gjendjes që e kemi në AAC dhe vlerësimi i dhënë nga Raporti i Progresit për AAC-në, është një lajm i mirë jo vetëm për AAC-në, por edhe për Kosovën. Po ashtu, tha se është mirë që janë bërë 60 inspektime të aeroplanëve të huaj. Ndërsa, sfidat që po paraqitën, nuk janë në kompetencën e AAC-së. Për rënien e udhëtarëve në ANP sugjeroi që të bëhen analiza më të detajuara, se cilët janë faktorët e rënies. Bëri pyetje: Cilët janë hapat që ka ndërmarrë AAC-ja, që hapësira e lartë ajrore e kontrolluar nga Hungaria, të kalojnë në kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës?

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil –AAC – Disa prej pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e Komisionit, nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejtë të

AAC-së dhe mund t'ju përgjigjemi pyetjeve vetëm për fushëveprimin e AAC-së. Pastaj, u përgjigj në pyetje të deputetëve, si vijon: lidhur me emërimin e zëvendës drejtorit të AAC-së nga Qeveria, tha se AAC-ja ka pasur nevojë për staf shtesë dhe për ndarje të përgjegjësive në mes të drejtorit dhe zëvendës drejtorit, mirëpo hulumtimet që janë bërë nuk ka pasur bazë ligjore që të zgjedhim ne vetë në AAC, por procedurat i ka udhëhequr Qeveria dhe ajo e ka zgjedhur, por është bërë e nevojshme për shkak të rritjes së aktiviteteve të shumta që i ka AAC-ja. Për anëtarësimin e AAC-së në Agjencinë Evropian të Aviacionit Civil –ICAO, tha se nuk ka pengesa ligjore, por ka pengesa politike. EASA-ja ka nënshkruar aranzhime pune me vendet e rajonit, por me Kosovën ende jo. EASA-ja ka kërkuar prej neve që kërkesa për aranzhime pune në EASA, të bëhet përmes Komisionit Evropian. Ai tha se Komisioni Evropian nuk sheh pengesa ligjore. EASA-ja është në konsultim të brendshëm për nënshkrimin e aranzhim punës, dhe sipas përshtypjes sonë, EASA-ja po heziton të nënshkruajë e para. Po presim që pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim- Asocimit, që të bëhet edhe nënshkrimi me EASA-në. Për marrjen hapësirës së lartë ajrore nga Hungaria, tha se Autoriteti i Aviacionit Civil është i gatshëm, së bashku Agjencinë e Shërbimeve të Navigimit Ajror, t'i marrë përgjegjësitë për kontrollimin e hapësirës së lartë ajrore nga Hungaria, por siç e dini, edhe këtu kemi të bëjmë me çështje politike, sepse është Këshilli i NATO-s që duhet të marrë vendim që këtë kompetencë t'ia kalojë shtetit të Kosovës. Për nivelin e kënaqshmërisë me shërbimet që ofrohen në ANP, tha se tani në tre muajt e fundit të viti 2015, kemi një rritje prej 10%. Për aterrimin e mundshëm të kompanive të fluturimeve nga Serbia, tha se Serbia deri më tani nuk ka bërë asnjë kërkesë në AAC për të ateruar në ANP. Kjo është çështje e dialogut që po zhvillohet mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Për shkurtimin e buxhetit të AAC-së, tha se nuk na është miratuar buxheti shtesë për punësime të stafit. Për subvencionet që po bën Maqedonia, tha që ka subvencione shumëdimensionale për kompanitë ajrore që subvencionojnë jashtë rregullave të Agjencisë Evropiane të Aviacionit Civil – ICAO. Këtë çështje e kemi e adresuar në Komisionin Evropian, por që ende nuk kemi marrë përgjigje. Për çmimin e lartë të biletave, tha se është çështje e rregullimit ekonomik dhe nuk është përgjegjësi e AAC-së, por e Ministrisë së Infrastrukturës. AAC-ja ka pranuar raportime të shumta dhe ka edhe të tilla të thjeshta, ku thuhet se nuk po punon kondicioneri dhe po më pengon në punë.

Fatmir Rexhepi – Pyeti për aterrimin e një kompanie ajrore që ka bërë një fluturim të ulët në Aeroportin e Gjakovës. A ka pasur leje dhe a ka pasur rrezik në hapësirën e ulët kjo kompani?

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil –AAC, duke u përgjigjur në pyetjen për aterrimin në Aeroportin e Gjakovës, tha se është bërë një hetim i detajuar dhe është marrë vendim nga AAC-ja, që të penalizohet piloti. Ndërsa, sa i përket Aeroportit të Gjakovës, tha se Qeveria do ta emërojë Bordin, pastaj Bordi e zgjedh menaxhmetin e Aeroportit të Gjakovës. Për nevojën se a duhet të ketë Bord AAC-ja, tha se Bordi nuk ka kompetenca ekzekutive, por vetëm është mbikëqyrës, ndërsa theksoi se a është nevoja që të ketë Bord AAC-ja apo jo, është çështje e Qeverisë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2014 të Autoritetit të Aviacionit Civil, me rekomandimet si vijon:

- *Qeveria, Ministria e Infrastrukturës dhe AAC-ja, të bëjnë zbatimin e Rekomandimeve të Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aviacionin civil, të datës 5.5.2014, në afat prej 6(gjashtë) muajsh, pas miratimit të këtyre rekomandimeve.*

- *Ministria të propozojë dhe Qeveria të zgjedhë Bordin Mbikëqyrës të AAC-së, në afat prej 3 (tre) muajsh pas miratimit të këtyre rekomandimeve.*

2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Visar Ymeri, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja

Visar Ymeri, kryesues – Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja e kemi shqyrtuar në një nga mbledhjet e kaluara, por që ka mbetur që grupi i punës t'i rishqyrtojë disa prej rekomandimeve dhe ta ristrukturojë raportin. Më pas, fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, z. Besim Beqaj, për të paraqitur Rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja.

Besim Beqaj – Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja, ka punuar në bazë të planit të veprimit dhe agjendës. Ai theksoi se grupi i punës e ka njoftuar Komisionin në mbledhjen e kaluar, për Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja, tani raporti final përfshin edhe pjesën e raportimit të znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë. Tanimë, raporti është i ristrukturuar dhe është i plotë. Ai tha se rekomandimet i kemi ndarë në tri 3 pjesë: për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe KIESA-n dhe institucionet tjera për zbatimin e ligjit. Në fund, i paraqiti rekomandimet të cilat i arsyetoi një nga një.

Kryesuesi – Pasi që nuk ka ndonjë sugjerim apo vërejtje në raport dhe rekomandime, kërkoi që të votohet Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja dhe të procedohet për seancë në Kuvend.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Qeveria e Republikës së Kosovës:

- *Në Programin Legjislativ për vitin 2015, ta përfshijë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për investimet e huaja;*
 - *Ndryshimet e ligjit të përfshijnë ndryshimin e emërimit të ligjit;*
 - *Zhvendosjen e KIESA-s në ZKM.*
- *Të nxjerrë vendim të veçantë, në rast të investimeve strategjike, investimeve me vlera të mëdha, si dhe investime të cilat punësojnë numër të madh të punëtorëve, që të ketë të drejtë t'ia japë tokën në shfrytëzim investitorit të huaj në harmoni me legjislacionin në fuqi.*
- *Të zbatohet Vendimi nr. 04/186 të datës 29.4.2014 për pushimin e taksave për një periudhë të caktuar.*
- *Të krijojë hapësirë për komunitetin e biznesit në hartimin e legjislacionit.*

2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

- *Të kërkojë që KIESA të themelojë Regjistrin e investitorëve të huaj dhe të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e mjedisit të përshtatshëm për NMVM-të, të*

krijojë kapacitete dhe t'u ofrojë përkrahje bizneseve edhe pas realizimit të investimeve.

- *T'i japë KIESA-s autorizim ligjor konform ligjeve në fuqi, që në emër të investorëve t'i kryejë të gjitha procedurat për nxjerrjen e lejeve dhe licencave.*
- *Dhe, KIESA, së bashku me odat ekonomike vendore dhe të huaja, të bëjnë promovimin e gjykatës së arbitrazhit, e cila vepron në Kosovë.*
- *Të përshpejtohet zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm të KIESA-së.*
- *Të kërkojë që KIESA të përmirësojë performancën e saj, në përkrahje të investimeve dhe të rrisë bashkëpunimin me komunitetin e biznesit.*

3. *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme të shtojnë efikasitetin në dhënien e lejeve të punës, përkatësisht të qëndrimit për punonjësit e huaj.*
4. *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të monitorojë zgjedhjen dhe emërimin e nëpunësve civilë në KIESA dhe t'i dorëzojë Komisionit një raport lidhur me këtë çështje, në afat prej tre muajsh, pas miratimit të këtyre rekomandimeve.*
5. *Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe institucionet përkatëse, të rishikojnë kushtet e furnizimit me energji dhe të njoftojnë ndërmarrjet apo bizneset për intervenimet në rrjet dhe ndërprerjen e paplanifikuar të energjisë elektrike, së paku 24 orë para ndërprerjes;*
6. *Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, të sigurojnë efikasitet në zbatimin e kontratave, të trajtojnë me prioritet kontestet ekonomike, të sigurojnë zbatim te barabartë të legjislacionit, të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar ekonomik.*

II. Arsyetimin lidhur me këtë Raport me rekomandime, do ta paraqesë deputeti Besim Beqaj, anëtar i Komisionit.

5. Të ndryshme

Blerim Grainca – E njoftoi Komisionin për një kërkesë që ka pranuar nga Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës, që po kërkojnë një takim me të gjithë deputetët e Komisionit. Lidhur me këtë kërkesë, propozoi që të futet në rendin e ditës për mbledhjen e radhës.

Me propozimin u pajtuan anëtarët e Komisionit, por mbetet që kryetari i Komisionit ta vendosë në agjendë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit,

Visar YMERI